

Iniciativa Qytetare LISTA PËR KAÇANIKUN

DEKLARATË POLITIKE

Iniciativa Qytetare LISTA PËR KAÇANIKUN do të veprojë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Zgjedhjet Lokale (03/L-072), Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (03/L-040), legjislacionin tjetër të zbatueshëm dhe Kodin e Mirësjelljes.

Iniciativa Qytetare LISTA PËR KAÇANIKUN objektiv të parë e ka qeverisjen në përputhje me ligjin, në të gjitha nivelet e pushtetit lokal në komunën e Kaçanikut. Korrupsionin dhe veprimet tjera të jashtëligjshme do t'i denoncojë, jo vetëm politikisht.

Iniciativa Qytetare LISTA PËR KAÇANIKUN është një grup njerëzish jopartiak, të cilët janë bashkuar për ta qar zërin e qytetarit të rëndomtë, përfshirë edhe grupet e marginalizuara, deri në organet vendimmarrëse të Komunës.

Gjithsesi, Iniciativa Qytetare LISTA PËR KAÇANIKUN do të jetë forcë kohezive politike, konstruktive në raportet me subjektet tjera politike të cilat veprojnë në komunën e Kaçanikut.

Iniciativa Qytetare LISTA PËR KAÇANIKUN do të angazhohet në interes të të gjithë qytetarëve të komunës së Kaçanikut, në përputhje me ligjin.

Kaçanik, 11.08.2017

Iniciativa Qytetare LISTA PËR KAÇANIKUN

Kjani Sallahu - kryetar

